



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 maj 2015
Nr. ref.: RK 801/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI146/14

Parashtrues

Bekim Cakolli

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 160/2013, të 8 tetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bekim Cakolli nga Prishtina, i cili momentalisht gjendet në vuajtje të dënimit me burg në Burgun e Dubravës, i përfaqësuar nga z. Bajram Tmava, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 160/2013, të 8 tetorit 2013, me të cilin Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
3. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, është cenuar neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI146/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI146/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 23 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Komunale në Prishtinë që të dorëzojnë kopjen e fletëkthesës me datën e pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 160/2013.
9. Më 18 shkurt 2015, Gjykata Komunale dorëzoi kopjen e fletëkthesës, e cila tregon se aktgjykimi kontestues i Gjykatës Supreme të Kosovës është pranuar nga parashtruesi i kërkesës më 10 nëntor 2013.
10. Më 25 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informata shtesë në Gjykatë me ç'rast ai pretendon se avokati i tij B.T. nuk e ka mbrojtur atë ligjërisht, sepse gjatë seancave ai nuk e lejoi atë të flasë.
11. Më 15 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 31 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi P. nr. 412/2010], e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprat penale dhe e dënoi atë me burg.
13. Më 26 shtator 2012, Gjykata Supreme e Kosovës [Aktgjykimin AP. nr. 378/2012], duke vendosur përkitazi me ankesat e parashtruesit të kërkesës (të akuzuarit) dhe Prokurorit Publik të Qarkut, miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë [P. nr. 412/2010], përkitazi me cilësimin juridik.
14. Pas kësaj, parashtruesi paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar shkeljen thelbësore të ligjit penal dhe duke kërkuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet.
15. Më 8 tetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës [Aktgjykimi, Pml. nr. 160/2013] refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 nëntor 2013.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe janë bërë shkelje esenciale të KPPK-së.
17. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:
 - *ANULIMIN e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, 412/2010 të datës 31.05.2012, aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.122/2012 të datës 07.06.2012 dhe PML.nr.160/2013 të datës 08.10.2013.*
 - *Kthimin e çështjes penale të të akuzuarit Bekim Cakolli në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda.*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, para së gjithash duhet të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”
20. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose [...].”

21. Aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës Supreme të Kosovës [Pml. nr. 160/2013], është nxjerrë më 8 tetor 2013, dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 nëntor 2013, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 2 tetor 2014, që është më shumë se 4 (katër) muaj nga dita kur i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës. Prandaj, kërkesa është dorëzuar pas afatit.
22. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Kadri Kryeziu




Prof. dr. Enver Hasani